REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 4853 Prot

Maliq, më 10.8.2026

URDHËR

Nr. 524, datë 10.8.2026

"Për ndalimin e punimeve për rrjetet ajrore të komunikimeve elektronike në territorin e Bashkisë Maliq"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", i ndryshuar, neni 64, gërma "a", ligjit nr.107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", i ndryshuar, neni 5, pika 1.3, shkronja "b", ligjit nr. 120/2016 "*Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit*", VKM nr.155, datë 11.03.2022 "*Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhenies se te drejtes së kalimit per ndertimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpjetesi te larte*", VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e punimeve për rrjetet ajrore të komunikimeve elektronike në territorin e Bashkisë Maliq, deri në sistemimin e rrjetit ajror ekzistues të komunikimeve elektronike.

2. Punimet e reja për rrjetet ajrore të komunikimeve elektronike në territorin e Bashkisë Maliq, do të nisin pas sistemimit të rrjetit ajror ekzistues dhe miratimit nga ana e Këshillit të Bashkisë Maliq të rregullave për administrimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike në territorin e bashkisë.

3. Bashkia Maliq në bashkëpunim me institucionet përkatëse, sipas një plani veprimi synon sistemimin e rrjeteve ajrore të komunikimeve elektronike nëpërmjet pastrimit, standartizimit dhe kalimit të tyre në kanale nëntokësore në zonat urbane.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Planifikimit, Kontrolli dhe Zhvillimit të Territorit, Sektori i Teknologjisë së Informaconit, Policia Bashkiake, dhe të gjithë operatorët e komunikimeve elektronike.

5. Komisariati i Policisë Maliq do të jetë në mbështetje të strukturave të Bashkisë Maliq për zbatimin e këtij urdhëri.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Maliq me qëllim njoftimin e operatorëve të komunikimeve elektronike.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026